



01 Nr. 441/26 Dt. 11.09.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet ftesa e Stiftung Zukunft Berlin dhe nisma e saj e Shoqërisë Civile “A Soul for Europe (ASfE), drejtuar kryetarit të Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj dhe Adem Morina, drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Prizrenit, për pjesëmarrje në Konferencën e Berlinit 2026, “Evropa: Arti i Përkatësisë”, që do të mbahet nga data 05 nëntor 2026 deri me 06 nëntor 2026, në Allianz Forum në Berlin të Republikës së Gjermanisë.
2. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën 04 nëntor 2026 dhe kthimi me 08 nëntor 2026, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit (bileta), akomodimit, ushqimit, mëditjeve si dhe të shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurit.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet Kabineti i Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Kabinetit të Kryetarit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

